



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-1815/25 datë:20.01.2025



Npi – 01/26 datë: 27.01.2025

Duke u bazuar në nenet 11, 12.2 pika (d) si dhe nenin 17 pika (k), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008); Nenin 5 të Statutit të Komunës së Shtimes, 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Nenet 13.2 dhe 13.3 si dhe nenin 14.1 të Rregullores Komunale për Varrezat Ofrimin e Shërbimeve të Varrimit, Rregullimin dhe Mirëmbajtjen e tyre, me numër: Npi – 01/77 të datës 28.03.2019; Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe financa Npi-01/13 dt. 24.01.2025; Rekomandimin e Komitetit për Komunitete Npi-01/16 dt. 24.01.2025; Propozim-Vendimin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Nr.07/03 dt.20.01.2025; Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e mbajtur më 27.01.2025, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT NË SHUMËN PREJ 300 €

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -I- të rregullt për vitin 2025, të mbajtur më: **27.01.2025**, unanimisht miratoi Vendimin për caktimin e çmimit në vlerë prej 300 euro për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për të gjithë qytetarët që varrosen në territorin e kufijve administrativë të Komunës së Shtimes.

II

Pagesa për qytetarët e komunitetit fetar Islam procedohet përmes Këshillit të Bashkësisë Islame – KBI në Shtime, mbi bazën e marrëveshjes dypalëshe që do të lidhet pas miratimit të këtij Vendimi.

III

Për qytetarët e komuniteteve të tjera fetare (ose për ata që nuk i përkasin asnjë komuniteti fetar), pagesa e shpenzimeve të varrimit bëhet sipas kërkesës nga familjarët e personave që ndërrojnë jetë.

IV

Pagesa për shpenzimet e varrimit të veteranëve dhe invalidëve të Luftës së UÇK-së bëhet sipas nenit 14.4 të Rregullores me numër Npi – 01/77 e datës 28.03.2019 për Varrezat, Ofrimin e Shërbimeve të Varrimit, Rregullimin dhe Mirëmbajtjen e tyre.

V

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

VI

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Zyrës Komunale për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Ministrisë për Financa dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi